REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8457/1 Prot.

Lushnje,më 16/10/2024

PROJEKT-VENDIM

NR. 95 DATË 16/10/ 2024

"PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I LUSHNJES" Z.IKONOM KOZMA DHIMA (pas vdekjes)"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij te datës / /2024, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetari Bashkisë "Për dhenien e titullit "Qytetar Nderi i Lushnjes për z.Ikonom Kozma Dhima (pas vdekjes)", si dhe mbeshtetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, germa "m"; Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor te nderit ne Republikën e Shqipërise", Ligjit 94/2024 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit Keshilli Bashkiak, neni 11,pika 2;

PROPOZOJMË:

1. Të vlerësohet me titullin "Qytetar Nderi i Lushnjes" **z.Ikonom Kozma Dhima** (pas vdekjes) me motivacionin:
   "Për kontribut të shquar atdhetar dhe patriotik në përhapjen dhe mësimin shqip."
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e QKKS.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtor i QKKS


Brizida Dervishi

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Adresa: Lagjja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

IKONOM KOZMA DHIMA



I dalë nga gjiri i një familjeje atdhetare në fshatin Stan Manastir të Lushnjës (sot i Fierit) dhe lindur në vitin 1869, Kozma Dhima pat kryer gjysmë gjimnazin greqisht të Beratit. Pasi kreu studimet, e emërojnë prift (dhjak) në kishën e Divjakës të rrethit të Lushnjës. Gjatë studimeve në Berat u mbrujt me idetë e rilindasve. Ka qenë nxënës i Babë Dudë Karbunarës. Atje mësoi të shkruajë e lexojë shqip vet, duke u ndihmuar nga shokët dhe mësuesët patriotë.

U njoh dhe krijoi miqësi me shumë patriotë myzeqarë, që shërbenin në Manastirin e Ardenicës, ose që mblidheshin këtu. Prej këtu, Kozmai merrte libra shqip dhe u mësonte fëmijëve dhe të rriturve shkrim e këndim shqip. Ai krijoi një rreth shoqëror dhe miqësor me Jani Mingën, Saqellarët e Manastirit të

Kolkondasit, me Uan Ndrekon etj. Kështu, ishte jo vetëm përhapës i shkrimit dhe i leximit shqip, por dhe një luftëtar e drejtues çete patriotike antiosmane në Libofshë, që e krijoi në vitin 1907.

Ikonom Kozma Dhimën e gjeti viti 1906 prift ikonom në Divjakë, si dhe mësues të gjuhës greke në shkollën pranë kishës së këtij fshati. Ai u përkrah nga populli i këtushëm.

Në këtë periudhë lëvizja antiosmane po ritej vazhdimisht. Osmanllinjtë po ndesheshin gati kudo në Myzeqe me bujqë të revoltuar. Po kështu, dhe në qytete. Viti 1906 shënon lëvizjet më të mëdha. Në vitin 1906, në maj të këtij viti, u bë një demonstratë e madhe antiosmane. Për organizimin e saj dha kontributin e tij edhe Kozma Dhima. Ai kishte siguruar lidhje të mira me patriotë lushnjarë nëpërmjet zv.dhespotit të Lushnjës, Ikonom Theodhor Zegalit. Ai siguroi shumë demostrues nga zonat e Libofshës dhe të Divjakës. Në këtë demostratë u treguan shumë aktiv.

Pas shtypjes së demostratës, forcat qeveritare arrestuan shumë pjesëmarrës dhe organizatorë, midis tyre edhe Ikonom Kozma Dhimën. E akuzuan si përhapës të gjuhës shqipe. Për këtë, mbas disa ditëve burg në Lushnjë, e internuan në Konjë. Kjo masë e indinjoi dhe e zemëroi pa masë popullin patriot të Lushnjës, Libofshës e të Divjakës. Kërcënimi i përndjekjes masave popullore e detyruan qeverinë ta lirojë pas disa muajsh. Pas kthimit nga internimi, ai e rriti edhe më shumë aktivitetin antiosman.

Gjatë viteve 1906-1907-1908, megjithëse shtypja ishte e madhe, lëvizja antiosmane dhe ajo për shkrim e hapja e shkollave shqipe, morën hov të madh.

Në korrik të vitit 1908 krye[illegible]

...mbledhën që në Myzeqe të hapeshin shkollat shqip, si në ...bofshë, Grabian, Divjakë, Karavasta, Kolonjë, etj.

Rezultatet e kësaj përpjekjeje dhe i shumë të tjerave, çuan në hapjen e shkollës së parë shqipe në Libofshë të Myzeqesë.

Rritja e lëvizjes për pavarësi, shtimi i çetave kryengritëse dhe rritja e tyre me vullnetarë në Myzeqe kërkonte komandantë e drejtues ushtarak për ngritjen e popullit në Kryengritje të Përgjithshme. Për këtë Ikonom Kozma Dhima u bëri thirrje myzeqarëve që shërbenin në ushtrinë turke, që të braktisnin repartet osmane dhe të bashkoheshin me kryengritësit, vëllezërit e tyre myzeqarë.

Në një letër që i dërgon ky patriot një kollazi (kapiten i parë) ndër të tjera i shkruan: *"I nderuari zoti Kollaz; të bëj thirrje në emër të luftëtarëve të kombit shqiptar, të largoheni nga ajo punë, dhe, si komandantë, të vini të merrni forcat shqiptare në dorëzim. Diturinë dhe mençurinë tuaj është e domosdoshme ta përdorni në interes të atdheut. Unë mendoj se këto forca që komandoj unë të takojnë ty. Unë, megjithatë, jam prift, por kur e lyp nevoja bëhem edhe komandant, edhe oficer apo ushtar për nevojat e kombit shqiptar. Ka ardhur koha, që ju ta braktisni atë detyrë dhe të vini këtu me vëllezërit tuaj dhe së bashku të luftojmë për mëmëdhenë. Lini ushtrinë turke e merrni forcat shqiptare, mjaft qëndruat në Elbasan me ta; ejani këtu në Lushnjë, se po ju presim.*

Të fala burrërore Ikonom Dhima

Si rezultat i punës këmbëngulëse për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe rritjen e dashurisë për atdhe, shumica e shqiptarëve që ndodheshin në ushtrinë turke, e braktisën atë dhe u rreshtuan në çetat e lirisë duke luftuar për pavarësinë e Shqipërisë. Për të arritur deri këtu, kryengritësve iu desh të bënin shumë goditje kundër pushtuesve. Po përmendim njërën nga

aksionin e përbashkët të çetave të Myzeqesë në korrik të vitit 1911 kundër garnizonit turk në qytetin e Lushnjës, që përfundoi me çlirimin e qytetit. Në këtë aksion mori pjesë edhe Ikonom Dhima.

Patrioti Ikonom Dhima në nëntor1912 e priti Ismail Qemalin, kur ky kaloi nëpër Myzeqe për në Vlorë. Pas vendosjes së Qeverisë së tij, Ikonom Dhima u vu në mbrojtje të saj. Ai luftoi kundër esadistëve e serbëve, që u vërsulën ta përmbysnin atë në mars të vitit 1913.

Sipas vendimeve të Qeverisë së Ismail Qemalit, Ikonom Dhima hapi shkollën e Ardenicës, ku punoi si mësues i gjuhës shqipe. Në vitin 1914, kur andartët grekë kishin hyrë në Shqipëri dhe i qenë afruar Beratit, ky patriot, bashkë me Zija Mullain, shkuan fshat më fshat, regjistruan vullnetarë për të luftuar dhe përzënë andartët grekë nga territori shqiptar.

Ikonom Dhima ka dhënë kontributin e tij në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës. Gjithashtu, ky patriot, me influencën e tij të Myzeqesë e Karatoprakut, nxori shumë vullnetarë dhe i dërgoi në Vlorë në verën e vitit 1920, të cilët luftuan deri në hedhjen e italianëve në det.

Ishte përkrahës i demokracisë, kundër ardhjes së Zogut në fuqi.

Vdiq dhe u varros i nderuar në vitin 1924.